

URDHËR
Nr. 474, datë 17.11.2020

**PËR PËRDITËSIMIN E URDHRIT TË MINISTRIT NR. 72, DATË 2.3.2017, “PËR
MIRATIMIN E LËNDËVE VEPRUESE NË PËRMBAJTJE TË PMB-ve”, të
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës si dhe të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin e ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar, bëhet përditësimi, me ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) miratohet për shtim në listën 2, 1 (një) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;
b) zgjaten afatet e regjistrimit për 65 (gjashtëdhjetë e pesë) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

c) hiqen 5 (pesë) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

2. Ky përditësim të pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit të PMB-ve, të regjistruara.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) të sigurojë të dhënat statistikore të PMB-ve çdo vit për sasitë e hedhura në treg, ndërsa Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB), çdo 5 vjet për sasitë e përdorura. Këto të dhëna përpunohen dhe raportohen nga zyra e statistikave në MBZHR, në sasi për lëndët vepruese të miratuara me urdhrin e ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, të ndryshuar dhe i dërgohen INSTAT-it për publikim.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL**
Bledar Çuçi

1. MIRATOHEN PËR SHTIM NË LISTËN 2, LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

Nr.	Emri i zakonshëm dhe nr. i identifikimit	Emërtimi IUPAC	Pastërtia	Aplikanti	Hyrja në fuqi	Skadimi	Dispozita specifike
1.	Sodium hydrogen carbonate CAS No: 144-55-8	Sodium hydrogen carbonate	≥ 990 g/kg. Arsenik ≤ 3 mg/kg; ≤ 2 mg/kg; Merkur ≤ 1 mg/kg.	BIOFA AG	1 tetor 2020	1 tetor 2035	Përdoret si fungicid dhe herbicid.

2. ZGJATEN AFATET E REGJISTRIMIT PËR LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

- Deri më 31 gusht 2021:

1. Aluminium ammonium sulphate;
 2. Aluminium silicate;
 3. Blood meal (miell gjaku);
 4. Calcium carbonate;
 5. Carbon dioxide;
 6. Ekstrakt nga pema e çajit;
 7. Fatty distillation residues (mbetje të distilimit të dhjamërave);
 8. Acide dhjamore C7 deri C20 (Fatty acids C7 to C20);
 9. Garlic extract (ekstrakt hudhre);
 10. Gibberellic acid (acid giberilik);
 11. Gibberellins (Giberelina);
 12. Hydrolysed proteins (proteina të hidrolizuara);
 13. Iron sulphate (sulfat hekuri);
 14. Diatomaceous earth (Kieselgur);
 15. Plant oils/rape seed oil (vajra bimore/vaj i farës së kolzës);
 16. Potassium hydrogen carbonate;
 17. Quartz sand (rëra e quarcit);
 18. Fish oil (vaj peshku);
 19. Repellents by smell of animal or plant origin/sheep fat (Replentë nga aroma e origjinës shtazore ose bimore/dhjamit të deleve);
 20. Straight Chain Lepidopteran Pheromones (Feromone të Lepidopterëve);
 21. Tebuconazole;
 22. Urea.
- Gjithsej: 22 lëndë vepruese.

- Deri më 31 tetor 2021:

1. Deltamethrin;
 2. Flufenacet;
 3. Fosthiazate;
 4. Chlorotoluron;
 5. Cypermethrin;
 6. Daminozide;
 7. MCPA;
 8. MCPB;
 9. Indoxacarb;
 10. Prosulfocarb;
 11. Fludioxonil;
 12. Clomazone.
- Gjithsej: 12 lëndë vepruese.

- Deri më 31 nëntor 2021:

1. Tritosulfuron.
- Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

- Deri më 31 dhjetor 2021:

1. Amidosulfuron;
 2. Nicosulfuron;
 3. Clofentezine ;
 4. Dicamba;
 5. Difenoconazole;
 6. Lenacil;
 7. Picloram;
 8. Bifenox;
 9. Diflufenican;
 10. Fenoxaprop-P;
 11. Fenpropidin;
 12. Triflusal;
 13. Sulphur;
 14. Tritosulfuron.
- Gjithsej: 14 lëndë vepruese.

- Deri më 31 janar 2021:

1. Mecoprop-P;
 2. Pyraclostrobin;
 3. Mancozeb;
 4. Metiram;
 5. Oxamyl;
 6. Dimoxystrobin.
- Gjithsej: 6 lëndë vepruese.

- Deri më 31 shkurt 2021:

1. Flutolanil;
 2. Benfluralin;
 3. Fluazinam;
 4. Mepiquat.
- Gjithsej: 4 lëndë vepruese.

- Deri më 1 dhjetor 2020:

1. Imidacloprid;
 2. Denathionium benzoate;
 3. Calcium phosphide;
 4. Zeta-cypermethrin.
- Gjithsej: 4 lëndë vepruese.

- Deri më 31 dhjetor 2020:

1. Haloxyp-P.
- Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

- Deri më 31 maj 2021:

1. Pencycuron.
- Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

Totali: 65 (gjashtëdhjetë e pesë) lëndë vepruese.

3. HIQEN LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

1. **Fenamiphos**. Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *Fenamiphos*, brenda datës 23 mars 2021.

2. **Bromoxynil**. Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *Bromoxynil*, brenda datës 14 mars 2021.

3. **Ethametsulfuron-methyl**. Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *Ethametsulfuron-methyl*, brenda datës 14 shtator 2021.

4. **Benalaxyl**. Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *Benalaxyl*, brenda datës 5 prill 2021.

5. **Thiophanate-methyl**. Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë *thiophanate-methyl*, brenda datës 19 prill 2021.

Gjithsej: 5 (pesë) lëndë vepruese.